

Termet e Referencës (ToR) për ofrues të shërbimeve One-To-One Coaching, Zhvillim të Platformave E-commerce & Zhvillim të Vlogs në kuadër të Projektit “Fuqizimi i Grave përmes Transformimit Dixhital”

Organizata: Këshilli i Konsulentëve të Biznesit

A. Informata të Përgjithshme

Këshilli i Konsulentëve të Biznesit (KKB-BCC), në bashkëpunim me Qeverinë Gjermane, përmes Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), po implementon Projektin “Fuqizimi i Grave përmes Transformimit Dixhital”. Ky projekt ka për qëllim rritjen e rolit të grave afariste të Kosovës në transformimin dixhital dhe për të krijuar dhe rritur një grup të NVM-ve në pronësi të grave për pjesëmarrje aktive në marketing dixhital, për të mbështetur zhvillimin e rritjes gjatë krizës, për të përmirësuar produktivitetin dhe konkurrencën që gjeneron rritje ekonomike.

BCC si partner implementues i projektit “Fuqizimi i Grave përmes Transformimit Dixhital” dhe si shoqata e vetme që përfaqëson konsulencën menaxheriale në nivel lokal, fton:

Për Aktivitetin 2: Konsulentë për shprehje të interesit si ofrues të One-To-One Coaching:

Kërkohen gjithsej 5 (pesë) konsulentë. Secili konsulent do të ofrojë One-To-One Coaching për 3 biznese. Në total, nga ky aktivitet do të përfitojnë 15 biznese (secili biznes nga 2 ditë).

Gjithsej 9 ditë pune për 1 konsulent (2x3 ditë One-To-One Coaching + 1x3 ditë raportim).

SHËNIM ME RËNDËSI:

- Të gjitha sesionet e mbajtura në kuadër të coaching, duhet të xhirohen. Konsulenti është i obliguar t'i dërgojë këto xhirime, menjëherë pas përfundimit të sesionit.
- BCC do t'iu dërgojë konsulentëve një formë raportimi, e cila duhet të plotësohet për secilin biznes.

Për Aktivitetin 3: Kompani për shprehje të interesit për zhvillim të platformave E-commerce (për shitje online).

Kërkohen gjithsej 5 kompani, nga 6 ditë pune secila. Secila kompani do të zhvillojë platformë E-commerce për 1 kompani përfituese të projektit. Nga ky aktivitet do të përfitojnë gjithsej 5 kompani.

Për zhvillimin e Vlogs: Kompani për shprehje të interesit për zhvillim të Vlogs (video të shkurta).

Kërkohet 1 kompani, e cila do të zhvillojë 10 Vlogs për 10 kompani përfituese të projektit.

B. Orari dhe kohëzgjatja e aktiviteteve

Aktiviteti 2 do të fillojë nga data 20.01.2021-02.02.2021.

Aktiviteti 3 do të fillojë nga data 05.02.2021-12.02.2021.

Zhvillimi i Vlogs do të fillojë nga data 16.03.2021-19.03.2021.

C. Objektivat e projektit

Objektivat e këtij projekti janë:

- Rritja e rolit të grave afariste të Kosovës në transformimin dixhital
- Krijimi dhe rritja e një grupi të NVM-ve në pronësi të grave për pjesëmarrje aktive në marketing dixhital,
- Mbështetja e zhvillimit të rritjes gjatë krizës,
- Përmirësimi i produktivitetit dhe
- Zhvillimi i konkurrencës që gjeneron rritje ekonomike.

D. Objektivat e aktiviteteve/Fushëveprimi dhe rezultatet e pritshme

Aktiviteti 2: 15 One-To One Coaching për gratë udhëheqëse të NVM-ve dhe 15 raporte individuale për secilin biznes.

Objektivat:

Përgatitja për e-marketing, duke ofruar shërbime këshilluese dhe trajnuese për të ndërtuar marketing dixhital për 15 NVM të drejtuara nga gratë.

Në total, 15 gra në biznes do të përfitojnë nga marketingu dixhital për të ndihmuar në transformimin dixhital përfshirë, por pa u kufizuar:

- Në menaxhimin dhe marketingun e mediave sociale,
- Azhurnimin dhe hartimin e një strategjie të faqes në internet,
- Gjenerimin dhe optimizimin e përmbajtjes,
- Marketingun me email.

Implementimi:

Në total, konsulentët do të ofrojnë nga 2 (dy) ditë One-To-One coaching dhe nga 1 ditë raportim për secilin nga 15 bizneset. Në total, ky aktivitet do të zgjasë 45 ditë, 30 ditë për One-To-One coaching dhe 15 ditë për raportim.

Rezultatet e pritshme:

- Njohja me marketingun dixhital dhe mjetet dhe teknikat kryesore në dispozicion;
- Krijimi i një plani të integruar të marketingut dixhital duke përdorur mjete Web (shablloni ose platformat ekzistuese);
- Zhvillimi i objektivave të qarta dhe të matshme për aktivitetet e marketingut dixhital;
- Krijimi i një faqe interneti, me përmbajtje të përshtatshme;
- Ndërtimi i profilit dixhital duke përdorur mjete të tilla si blogjet, përmbajtja e marketingut dhe marketingu i mediave sociale, etj;
- Hartimi, zhvillimi dhe ofrimi i një propozimi/përvoje atraktive nga marketingu dixhital;
- Përdorimi i metrikave dhe analizave dixhitale si dhe mediave sociale për të vlerësuar suksesin e aktiviteteve të marketingut dixhital.

Aktiviteti 3: Përzgjedhja e 5 NVM-ve të drejtuara nga gratë pjesëmarrëse, për t'u mbështetur me platformën E-commerce

Objektivat:

Përzgjedhja e 5 (pesë) bizneseve të udhëhequra nga gratë, të cilat kanë më së shumti potencial për shitje online, përmes platformës E-commerce.

Implementimi:

Prej 15 bizneseve nga One-To-One coaching, do të përzgjedhen 5 biznese, për të cilat do të zhvillohen platformat për shitje online.

Zhvillimi dhe mirëmbajtja e platformës për vitin e parë do të mbulohet nga projekti, kurse pas vitit të parë, kostot i paguan vet biznesi.

Rezultatet e pritshme:

- Implementimi i platformave E-commerce për 5 biznese
- Të kuptuarit e shitjes me pakicë në E-commerce
- Analiza e ndikimit të E-commerce në modelet dhe strategjinë e biznesit. Kompania do të jetë përgjegjëse për të zhvilluar dhe identifikuar ndikimin e platformës E-commerce. Kështu, kompania që do të zbatojë platformën E-commerce do të ndajë gjithashtu modelet më të mira të biznesit me BCC, GIZ dhe bizneset e udhëhequra nga gratë.
- Sigurimi i praktikave dhe mjeteve më të mira për shitje online, përmes kompanisë që do të implementojë platformën E-commerce.

Vlogs: Përzgjedhja e 10 NVM-ve të drejtuara nga gratë pjesëmarrëse, për t'u promovuar përmes Vlogs.

Objektivat:

Përzgjedhja e 10 (dhjetë) bizneseve të udhëhequra nga gratë, të cilat kanë më së shumti nevojë për promovim përmes Vlogs.

Implementimi:

Prej 15 bizneseve nga One-To-One coaching, do të përzgjedhen 10 biznese, për të cilat do të zhvillohen Vlogs.

***Konsulentët/kompanitë konsulente do të bashkëpunojnë me ekipin e BCC dhe GIZ dhe në mënyrë të vazhdueshme do të raportojnë për progresin e aktiviteteve (BCC do të caktojë afatet kohore për raportim).**

E. Lokacioni

Format virtual (Platforma ZOOM ose platformë tjetër). Kjo vendoset në dakordim mes BCC dhe konsulentit.

F. Kompetencat, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Konsulentëve/Kompanive:

Aktiviteti 2: Konsulentët:

1. Diplomë universitare në fusha që lidhen me marketing/menaxhim;
2. Të paktën 5 vjet përvojë pune relevante;
3. Përvojë e gjerë në ndërtimin e kapaciteteve;
4. Demonstrim i nivelit të lartë të profesionalizmit dhe aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në situata me presion nën afate të ngushta;
5. Shkathtësi të shkëlqyera të komunikimit ndër-personal;
6. Aftësi të shkëlqyera të komunikimit dhe shkrimit në gjuhën shqipe dhe angleze.
7. Qasje interaktive
8. Të xhirojë sesionet One-To-One Coaching me secilin biznes.
9. Të përgatisë një raport final në gjuhën shqipe dhe angleze për ta ndarë me BCC dhe GIZ pas përfundimit të One-To-One Coaching.

Aktiviteti 3: Kompania duhet:

1. Të ketë përvojë në zhvillimin e platformave E-commerce (për shitje online)
2. Të ketë fleksibilitet në ndërtim të platformës E-commerce

Vlogs: Kompania duhet:

3. Të ketë përvojë në zhvillimin e Vlogs (video të shkurta)
4. Të ketë fleksibilitet në zhvillimin e Vlogs

G. Procesi i Aplikimit

Aktiviteti 2: Konsulentët e interesuar të cilët kanë përvojë dhe / ose kualifikim të mjaftueshëm, duhet të paraqesin dokumentacionin bazë i cili përfshin:

- Formulari i aplikimit (bashkëlidhur)
- CV
- Portfolio profesionale
- 3 referenca nga klientët

Aktiviteti 3: Kompanitë e interesuara të cilat kanë përvojë në zhvillimin e platformave E-commerce, duhet të paraqesin dokumentacionin bazë, i cili përfshin:

- Portfolio e platformave të zhvilluara
- 3 referenca nga klientët

Vlogs: Kompanitë e interesuara të cilat kanë përvojë në zhvillimin e Vlogs, duhet të paraqesin ofertat e tyre.

H. Kriteret e përzgjedhjes

Aktiviteti 2:

- Përvoja relevante = 30 pikë
- Referencat = 20 pikë
- Shkollimi = 20 pikë
- Çmimi i ofertës = 30 pikë

Aktiviteti 3:

- Portfolio = 30 pikë
- Referencat = 30 pikë
- **Çmimi i ofertës = 40 pikë**

Vlogs:

- Përvoja mbi 15 vjet = 50 pikë
- Çmimi i ofertës = 50 pikë

Dokumentet lidhur me këtë shpallje duhet të dorëzohen tek e-mail adresa: info@bcc-ks.org, jo më vonë se **18 janar 2021**. Në subjekt të e-mailit, ju lutem shënoni: “**Aplikim: GIZ/BCC - Aktiviteti përkatës** (2 ose 3, ose Vlogs)”

Ofertat e marra do të vlerësohen nga një panel i përbërë nga stafi i BCC dhe GIZ Kosova.